

Kumtesë

Të nderuar,

Instituti i Shëndetit Publik kreu një kontroll të jashtëzakonshëm në zonën e prekur dhe të dielën (14.09.25) u morën mostra nga një ekip i profesionistëve nga ISHP-ja për testimin e radioaktivitetit në ujë, tokë dhe ajër, si dhe mostra për testimin e metaleve të rënda në tokë, tokë dhe testimin e metaleve të rënda në ujë.

Gjatë ditës së djeshme (15.09.25) ISHP njoftoi se sipas rezultateve dhe analizave të kryera, në mostrat e marra nuk u vërtetua prani e radioaktivitetit në ajër dhe tokë, as prani e metaleve të rënda në ujë.

Gjatë ditës së sotme (16.09.25) ISHP i përfundoi analizat e mostrave për testimin e metaleve të rënda në tokë, si dhe analizat për radioaktivitet në ujë.

Sipas rezultateve të fituara ju informojmë si vijon. Mostrat u morën nga disa vende në zonën e prekur për testimin e metaleve të rënda në tokë, përkatësisht: Pb, Cd, As, Ni, Hg Cr, Cu, Zn, Sn, Ba, Be, Co, V, Tl, Mo, Sb. Pas analizimit të rezultateve të të gjitha mostrave të marra mund të përfundohet se nuk ka devijim nga vlerat referente për të gjitha 16 metalet e rënda të testuara (Pb, Cd, As, Ni, Hg Cr, Cu, Zn, Sn, Ba, Be, Co, V, Tl, Mo, Sb). Rritje e 2 parametrave Cu (bakër) dhe Zn (zink) vihet re vetëm nga një vend i testuar, që është shtresa sipërfaqësore ku digjeshin bateritë e litiumit dhe kjo është brenda pritshmërive. Në të gjitha vendet e tjera nuk ka devijim nga vlerat referente për 16 metalet e rënda të testuara.

Siç e përmendëm më lartë, gjatë ditës së sotme u bë edhe testim i radioaktiviteti në mostrat e ujit dhe sipas rezultateve të fituara në to nuk ka radioaktivitet.

Instituti i Shëndetit Publik për një kohë shumë të shkurtër arriti t'i kryejë analizat e nevojshme. Ato do të përsëriten në përputhje me protokollin në kohën e caktuar për këtë gjë.

ISHP vazhdon të punojë në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të gjitha institucionet shtetërore kompetente, ndërsa publiku do të informohet në kohë për çdo aktivitet të mëvonshëm.

Me respekt,

ISHP